

DITARI MUJOR

**TETOR
2025**REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E TURIZMIT,
KULTURËS DHE SPORTIT

SHQIPËRIA PREZANTON VIZIONIN PËR TURIZMIN E QËNDRUESHËM NË FHS DUBAI 2025



Në Future Hospitality Summit 2025, Shqipëria prezantoi vizionin e saj për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe inovacionit në mikpritje. Me përfaqësim dinjitoz ndër 200 folës dhe 50 vende pjesëmarrëse, vendi ynë u pozicionua si shembull i transformimit nga turizmi sezonal në ofertë të qëndrueshme gjatë gjithë vitit.

SHQIPËRIA FORCON PARTNERITETIN TURISTIK ME GJERMANINË DHE POLONINË



Në Tiranë u mirëpritën operatorë të njohur turistikë gjermanë për një tur inspektimi të destinacioneve shqiptare, duke forcuar lidhjet me tregun gjerman. Ndërkohë, kompania ITAKA po planifikon linjë direkte me aeroportin e Vlorës, duke rritur potencialin për arritjen e objektivit prej 500 mijë vizitorësh gjermanë në 2025.

SHQIPËRI-TURQI: BASHKËPUNIM STRATEGJIK NË TURIZËM DHE KULTURË



Në kuadër të Samitit Ekonomik Shqipëri-Turqi u mbajt një takim me Zëvendësministrin turk të Kulturës dhe Turizmit, Dr. Serdar Çam, për të forcuar partneritetin në fushën e investimeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm turistik. Samiti theksoi rëndësinë e turizmit si urë bashkëpunimi ndërkulturore dhe nxitës ekonomik.

DIALOG PËR TURIZMIN GLOBAL ME SHAIKHA NASSER AL NOWAIS NË ABU DHABI

Gjatë një takimi me Shaikha Nasser Al Nowais, lidere në fushën e mikpritjes globale dhe e zgjedhur Sekretare e Përgjithshme e Turizmit në UN Tourism nga janari 2026, u diskutuan rrugë të reja bashkëpunimi për turizëm të qëndrueshëm. Takimi hapi horizonte të reja për partneritetet mes Shqipërisë dhe Emirateve të Bashkuara Arabe.



SHQIPËRI-EMIRATET: PARTNERITET PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË TURIZËM, KULTURË DHE SPORT



Në takimin me Ministrin e Ekonomisë dhe Turizmit të Emirateve, Abdulla Bin Touq Al Marri, u thellua bashkëpunimi në fusha strategjike si turizmi, kultura dhe sporti. Palët u zotuan për shkëmbim eksperiencash dhe për zhvillim të qëndrueshëm në industrinë e mikpritjes dhe promovimin ndërkombëtar të Shqipërisë.

ROTANA HOTELS, INVESTIME STRATEGJIKE PËR TURIZMIN SHQIPTAR



Në kuadër të FHS Dubai 2025, u zhvillua takim me Nasser Al Nowais, Kryetar i Bordit të Rotana Hotels, për mundësitë e bashkëpunimit në investime strategjike dhe zhvillimin e destinacioneve të reja turistike. Synimi është promovimi i Shqipërisë si qendër e turizmit të qëndrueshëm dhe të nivelit të lartë në rajon.

STRATEGJIA KOMBËTARE E KULTURËS 2026–2030: NJË VIZION I RI PËR KRIJIMTARINË SHQIPTARE



U lançua Strategjia Kombëtare e Kulturës 2026–2030, një dokument strategjik që synon të forcojë institucionet kulturore, të mbështesë artistët dhe të investojë në trashëgimi e infrastrukturë kulturore. Në bashkëpunim me AICS dhe Fondacionin Santagata, strategjia projektin një vizion të ri për artin dhe kulturën si motor zhvillimi dhe afirmimi të identitetit kombëtar në rajon.

VIZITA E KRYETARIT TË BASHKISË SË NEW YORK-UT, ERIC ADAMS, NË TIRANË: URA E RE E BASHKËPUNIMIT KULTUROR

Kryetari i Bashkisë së New York-ut, Eric Adams, vizitoi hapësirat kulturore të Parkut të Artit dhe “Tirana Training Center” në Kinostudio, ku u diskutua për bashkëpunime në kulturë, turizëm dhe krijimtari. Takimi shënoi një hap të rëndësishëm në thellimin e lidhjeve shqiptaro-amerikane dhe promovimin ndërkombëtar të Tiranës si qendër e re kulturore.



EKSPOZITA INTERAKTIVE E PIRAMIDËS: INOVACION NË ZEMËR TË TRASHËGIMISË



Koncepti i ri i Ekspozitës Interaktive të Piramidës, realizuar nga AADF, do ta transformojë këtë monument në një qendër bashkëkohore që ndërthur teknologjinë me trashëgiminë. Projekti synon të sjellë një përvojë të re për vizitorët dhe të bëhet simbol i Tiranës moderne që bashkon historinë me inovacionin.

ADF DHE BUTRINT MANAGEMENT FOUNDATION: PARTNERITET PËR TRASHËGIMI DHE ZHVILLIM LOKAL



Takimi me përfaqësues të AADF dhe Fondit të Menaxhimit të Butrintit konfirmoi ecurinë pozitive të projekteve të përbashkëta në trashëgimi, turizëm dhe zhvillim komunitar. Bashkëpunimi po kthen idetë në projekte konkrete që gjallërojnë zonat lokale dhe e shndërrojnë trashëgiminë në burim të qëndrueshëm vlerash.

60-VJETORI I INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS: NJË HISTORI PËRKUSHTIMI DHE VIZIONI

Instituti i Monumenteve të Kulturës festoi 60-vjetorin e tij, duke nderuar dekada pune në mbrojtjen dhe restaurimin e trashëgimisë kombëtare. Ky jubile u shënua si moment reflektimi për kontributin e specialistëve dhe si pikënisje e re drejt zhvillimit të qëndrueshëm kulturor.



SHQIPËRI-ITALI: HORIZONTE TË REJA BASHKËPUNIMI NË ART DHE KULTURË



Në takim me AICS dhe Ambasadën Italiane në Tiranë, u diskutuan projekte të përbashkëta për artin, kinemanë dhe krijimtarinë, përfshirë realizimin e Muzeut Italian me koleksione të MAXXI dhe zhvillimin e eventeve të përbashkëta në 2026. Qëllimi është forcimi i urave kulturore mes dy vendeve.

“ALBANIAN SOUNDSCAPES” NË DUBAI: ZËRI SHQIPTAR QË PUSHTON SKENËN NDËRKOMBËTARE



Në Future Hospitality Summit 2025 në Dubai, pavijoni shqiptar “Albanian Soundscapes”, i kuruar nga AKPT dhe AZHT, u vlerësua ndër më të veçantët. Ai prezantoi Shqipërinë përmes muzikës, arkitekturës dhe peizazheve, duke ndërthurur traditën me modernitetin në një format novator që tërhoqi vëmendjen e botës.

SHQIPËRI-EMIRATET E BASHKUARA ARABE: SINERGJI PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE KULTUROR

Në takimin me CEO-n e Dhomës së Tregtisë së Dubait, Mohammad Lootah, u riafirmua bashkëpunimi ekonomik e institucional mes dy vendeve. Diskutimet u përqendruan në partneritete për turizëm, kulturë dhe ekonomi krijuese, duke pozicionuar Shqipërinë si destinacion tërheqës për investime të qëndrueshme.



PROJEKTLIGJI I RI PËR VULLNETARIZMIN: NJË HAP DREJT PËRFSHIRJES RINORE



Në Komisionin për Çështjet Europiane u prezantua projektligji i ri “Për Vullnetarizmin”, që synon të zgjerojë mundësitë për të rinjtë, të krijojë platformën elektronike të vullnetarizmit dhe të nxisë mobilitetin ndërkombëtar. Reforma e re forcon qytetarinë aktive dhe afron Shqipërinë me standardet evropiane.

UNIVERSAL MUSIC GROUP, NË SHQIPËRI PËR INVESTIME NË TURIZMIN KULTUROR



Përfaqësues të Universal Music Group shprehën interes për projekte që bashkojnë artin me turizmin, duke shfrytëzuar potencialin e vendit për prodhime artistike e filmike. Modelet e propozuara parashikojnë investime në hapësira kreative, teatro dhe studio, duke pozicionuar Shqipërinë si destinacion kulturor ndërkombëtar.

KONKURSI NDËRKOMBËTAR PËR PALLATIN E SPORTIT “ASLLAN RUSI” HAP RRUGËN E NJË EPOKE TË RE SPORTIVE



Gjashtë skuadra arkitektësh prezantuan idetë për rilindjen e Pallatit të Sporteve “Asllan Rusi”, një projekt që synon ndërtimin e një qendre moderne me kapacitet prej 6 mijë spektatorësh. Ky transformim do të shërbejë si model zhvillimi për sportin shqiptar dhe nxitje për turizmin sportiv në kryeqytet.

SHQIPËRIA BASHKËORGANIZATORE E KAMPIONATIT EUROPIAN U21: SPORT, RINI DHE ZHVILLIM

Në bashkëpunim me FSHF-në, Shqipëria dhe Serbia do të mirëpresin Kampionatin European të Futbollit U21, një ngjarje që promovon frymën e lojës së ndershme dhe energjinë e rinisë. Organizimi i këtij eventi do të sjellë investime në infrastrukturë, rritje të kapaciteteve sportive dhe afirmim të vendit si destinacion mikpritës e modern në arenën europiane.



DURRËSI MIKPRITËS I KAMPIONATIT BOTËROR TË SHAHUT PËR TË RINJ



Mbi 700 shahistë nga 80 vende të botës morën pjesë në Kampionatin Botëror të Shahut për të Rinj FIDE U14–U18, mbajtur në Durrës. Ky event vendosi qytetin bregdetar në qendër të hartës ndërkombëtare të sportit, duke dëshmuar aftësinë organizative të Shqipërisë dhe fuqinë bashkuese të sportit, kulturës dhe turizmit.

JAVA KULTURORE JAPONEZE: KUR ARTI DHE SPORTI FLASIN TË NJËJTËN GJUHË



Në kuadër të Javës Kulturore Japoneze, sporti dhe arti u bashkuan në një dialog frymëzues mes Shqipërisë dhe Japonisë, me pjesëmarrjen e Federatës Shqiptare të Arteve Marciale dhe Ambasadorisë Japoneze. Ndër më të spikaturit ishte xhudisti Jon Vrenozi, i cili u rendit i pari në garë, duke simbolizuar disiplinën, përkushtimin dhe karakterin e sportistit shqiptar.

SUKSES HISTORIK PËR SHQIPËRINË NË KAMPIONATIN BALLKANIK TË TAEKWONDO-SË 2025

Në kampionatin e zhvilluar në Bullgari, ekipi shqiptar i taekwondo-së fitoi 13 medalje dhe u rendit në vendin e tretë ekipor mes 12 shteteve pjesëmarrëse. Ky rezultat shënon një moment krenarie për sportin shqiptar, duke reflektuar pasionin dhe përkushtimin e sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare.



SHQIPËRIA MIKPRET KAMPIONATIN EUROPIAN TË SNOOKER 2025



Durrësi do të mirëpresë mbi 400 sportistë nga 38 vende në Kampionatin European të Snooker 2025, nën kujdesin e European Billiard & Snooker Association. Ky aktivitet përfaqëson një tjetër hap në afirmimin e Shqipërisë si vend organizator i eventeve të mëdha dhe si destinacion sportiv në Evropë.

“AUTO MOTO PARK ALBANIA” DREJT BASHKËPUNIMIT ME YAS MARINA CIRCUIT



Në Abu Dhabi u zhvillua një takim pune për bashkëpunim teknik me Yas Marina Circuit për projektin “Auto Moto Park Albania” në Elbasan. Projekti pritet të pozicionojë vendin në hartën ndërkombëtare të sporteve motorike, duke ndërtuar një qendër rajonale për sport, turizëm dhe inovacion.

DIPLOMACI SPORTIVE ME EMIRATET E BASHKUARA ARABE: URA TË REJA BASHKËPUNIMI

Në takimin me Ministrin e Sporteve të Emirateve, Ahmad Belhoul Al Falasi, u diskutua për nisma të përbashkëta në sportet elitare, evente ndërkombëtare dhe zhvillim të infrastrukturës sportive. Partneriteti pritet të sjellë investime dhe projekte që bashkojnë sportin me turizmin dhe ekonominë kreative.

